

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Mamusha – Raporti komunal

Tetor 2009

Mamusha në shifra

Popullsia	Gjithsej	5,000
	Turq	90%
	Shqiptarë	9%
	Të tjerë	1%
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	12.4 km²
	Numri i fshatrave	-
	Nr. i nxënësve	1013
	Nr. i mësimitdhënësve	55
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	1
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	1
	Nr. i çerdheve	0
Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	1
	Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore	0
	Nr. i mjekëve	4
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	3,050
	Të punësuar në sektorin publik komunal	113
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	723,311
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	61,440
	Të hyrat tjera (Euro)	661,871
Shpenzimet e realizuara (2008)¹	Gjithsej (Euro)	451,523 (83%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	66,089 (53%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	385,434 (92.6%)
Kryetarët e Komunës	2007-2009: Arif Bytyq	

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

Shkurt për Mamushën

Mamusha është komuna e vetme në Kosovë me popullsi shumicë turke. Deri në vitin 2005, Mamusha ka qenë pjesë e territorit të Prizrenit. Si komunë në vete Mamusha është themeluar me Urdhëresën Administrative 2005/11 me datë 27 shtator 2005. Neni 2 i kësaj urdhërese kërkon themelimin e pesë njësive pilote të komunave brenda komunave pjesë e së cilave kanë qenë. Kësisoj në bazë të kësaj urdhërese u formua komuna e Junikut, Parteshit, Hanit të Elezit, Mamushës dhe Graçanicës. Sot, Mamusha përfshinë një territor prej 12.4 km² dhe ka një popullatë prej 5,000 banorëve, 90% e të cilëve janë turq, dhe vetëm 9% shqiptar. Ekonomikisht kjo komunë nuk qëndron keq, ku mbi 100 ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Mamusha njihet për kultivimin e tokës, sidomos për rritjen e domates, kastravecit, lakrës etj. Madje kjo komunë njihet edhe për festivalin e domateve. Meqenëse Mamusha është një komunë e re, ku madje akoma nuk janë mbajtur zgjedhje lokale, mungojnë edhe shumë të dhëna krahasuese për këtë komunë. Prandaj, zgjedhjet e Nëntorit 2009 do të shënohen në historinë e kësaj komune të re si zgjedhjet e para lokale të mbajtura ndonjëherë.

Problemet aktuale

Edhe pse që nga themelimi i kësaj komune janë bërë investime të dukshme, kryesisht nga donacione që kanë ardhur nga Turqia, banorët e kësaj komunë megjithatë ende ballafaqohen me disa probleme esenciale sikurse uji i pijes. Pasi se shumica e banorëve sigurojnë të ardhurat e tyre nga kultivimi i tokës bujqësore, ata duhet të kishin një treg të posaçëm për plasimin e prodhimeve, gjë që nuk e kanë. Në përgjithësi problemet më aktuale të kësaj komune konsiderohen:

- Mos figurimi i gjuhës turke në dokumentin personal
- Sistemi i ujësjellësit
- Kundërmimi që sjell lumi i fshatit
- Mungesa e tregut për fermerët lokal
- Mungesa e shtëpisë së kulturës

Kur dihet se 90% e popullatës së kësaj komune i takojnë nacionalitetit turk, ata ndihen të shqetësuar për **mos figurimin e gjuhës turke në dokumentet personale**. Një gjë të tillë qytetarët e kësaj komune e konsiderojnë si të pa drejtë pasi se gjuha turke është një ndër gjuhët zyrtare të kësaj komune. Ata kërkojnë që në dokumentin personal si Letërnjoftimi, Patentë Shoferi etj., krahas gjuhës shqipe, dhe angleze të figuroj edhe gjuha turke, pasi që shumica e banorëve të kësaj komune i përkasin komunitetit turk. Këtë të drejtë ata e mbështesin në Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare, Neni 1.2.

Banorët e kësaj komune nuk janë të kënaqur me **sistemin e ujësjellësit**. Mamushës i mungon një sistem më efikas i ujësjellësit. Deri më tani banorët furnizohen me ujë nga një burim që ka ndërtuar komuna ku bëhet grumbullimi i më se 200 t. ujë. Nga ky grumbullim i quajtur 'Tumbada' uji shpërndahet nëpër tërë qytetin me anë të pompave që punojnë me rrymë. Kështu që në mungesë të rrymës ka edhe mungesë të ujit. Qytetarët shprehen për një mundësi të sjelljes së ujit nga Liqeni i Radoniqit, sistem ky i cili nuk do të varej nga rryma. Bashkë me ujin, qytetarët kanë problem edhe me furnizimin me rrymë. Ata ankohen se rryma është shumë e dobët, deri në

110 volt, gjë që në krahasim me pagesën e rregullt që bëjnë, duhet të jetë shumë më e fortë.

Edhe pse lumi që kalon nëpër qytet i jep një pamje të bukur kësaj treve, **kundërmimi dhe era e keqe e lumit** është shqetësuese për banorët. Ndotja e ujit të lumit bëhet jo vetëm nga banorët e vendit, por ky lum sjell edhe ujërat e zeza të disa fshatrave të tjerë. Kundërmimi që lëshon ky lum është një problem që shqetëson banorët e kësaj komune.

Mungesa e tregut për fermerët lokal. Sipas banorëve të kësaj treve, 60 për qind e popullatës merren me bujqësi. Prodhimet e tyre ata detyrohen t'i dërgojnë në Prishtinë të cilat ua shesin tregtarëve të Prishtinës me një çmim jo shumë të volitshëm. Ata ankohen se shpesh investojnë më tepër se sa që përfitojnë nga shitjet e prodhimeve. Ndër prodhimet më të famshme bujqësore të kësaj komune konsiderohen domatet, trangujt, lakrat etj. Mungesa e një tregu për plasimin e prodhimeve të tyre është një problem me të cilin ballafaqohen qytetarët e Mamushës për çdo sezon.

Mamusha njihet për veshje të ndryshme tradicionale që janë pjesë e kulturës kombëtare, por kësaj komune i **mungon shtëpia e kulturës**. Qytetit i Mamushës është ndër të rrallët që i mungon një Shtëpi e Kulturës ku do të zhvilloheshin aktivitete kulturore si dhe do të shërbente si vend tubimi për qytetarët e kësaj treve. Shoqatat kulturore artistike ankohen se deri më tani ata janë detyruar t'i mbajnë koncertet apo manifestimet e ndryshme kulturore në rrugë. Përveç shtëpisë së kulturës mungon edhe palestra e sportit.

Kuvendi Komunal dhe kryetari i komunës

Komuna e Mamushës nuk ka një histori të gjatë të ekzistimit të saj. Kjo komunë së pari filloi të funksionoj si pilot komunë, e mbështetur në Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2005/11. Që nga fillimi, kryetar i kësaj komune ishte emëruar Arif Bytyq, i cili edhe më herët kishte qenë kryetar i fshatit. Pasi se në këtë komunë asnjëherë nuk kishte pas zgjedhje lokale andaj edhe kryetari aktual nuk kishte pas rastin të jap premtime elektorale. Megjithatë, që nga themelimi i kësaj komune, kryetari Bytyq ka arritur të realizoj disa projekte madhore.

Padyshim e arritura më e madhe për banorët e kësaj komune konsiderohet të jetë kapërcimi me sukses i fazës testuese dhe marrja e epitetit të komunës. Kjo padyshim se ia ka lehtësuar dukshëm jetën 5000 banorëve të Mamushës, që tani të gjithë dokumentet e nevojshme i marrin aty. Ndërtimi i objektit të komunës, ndërtimi i shkollës moderne fillore 'Haxhi Ymeri' që ka kushtuar rreth 1.2 milion euro, ndërtimi i ambulancës, asfaltimi i rrugëve nëpër qytet, si dhe ndërtimi i Parkut të Qytetit, janë disa nga të arriturat të cilat i atribuohen suksesit të kryetarit Arif Bytyq.

Zgjedhjet lokale në Komunën e Mamushës për herë të parë do të mbahen me 15 Nëntor 2009. Partia më e madhe në këtë komunë konsiderohet të jetë Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) e cila në këto zgjedhje ka rikandiduar Arif Bytyq. Ky i fundit për kundërshtar në këto zgjedhje do ta ketë Mehmet Mazrek, i cili vjen nga radhët e AKR-së.

Nga gjithsej 15 ulëse sa ka Kuvendi Komunal i Mamushës, deri më tani 13 i kanë takuar deputetëve nga radhët e KDTP, kurse dy ulëse kanë qenë për dy kandidatë të pavarur. Ja se si duket tabela e KK të Mamushës:

Edhe në zgjedhjet e Nëntorit 2009, KK i Mamushës do ti ketë 15 ulëse. Në të gjithë komunat e Kosovës numri i votuesve ka shkuar gjithnjë dukë rënë në tri palë zgjedhjet e kaluara. Meqë në Komunën e Mamushës zgjedhjet mbahen për herë të parë, pritet që pjesëmarrja në zgjedhje të jetë e kënaqshme. Qytetarët pritet të dalin në votime më shumë të inspiruar nga entuziazmi që votojnë për herë të parë në komunën e tyre se sa nga gara e partive politike në këtë komunë. Numri i qytetarëve me të drejtë vote në këtë komunë është 2,837.

Buxheti i Komunës

Komuna e Mamushës për vitin 2009 kishte një buxhet prej 723,311 euro, prej të cilave 186,375 euro kanë qenë të destinuara për investime kapitale. Për vitin 2009 komuna kishte planifikuar të hyra vetanake prej 61,440 euro. Por në gjashtë mujorin e parë komuna ka realizuar të hyra në vlerë 9,885 euro, që është vetëm 16.9% i të hyrave të planifikuara. Kjo, sipas raportit të komunave të Kosovës janar – qershor 2009, e bën Mamushën komunën që ka realizuar më së pakti të hyra vetanake.

Investimet kapitale

Në tabelën e më poshtme mund të shihni dy nga projektet kapitale të realizuara gjatë dy viteve të kaluara si dhe koston e tyre:

Tab.1.: Investimet kapitale në Mamushë gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Shtruarja e tretuareve anësore	€20,274
2009	Vazhdimi i ujit Pish-Mamushë	€19,435

Kuvendi Komunal i Mamushës veç ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Buxheti i përgjithshëm i komunës pritet të rritet nga viti në vit dhe bashkë me të do të rritet edhe shuma për investime kapitale. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Mamushës do të ketë në dispozicion 770,014 euro për investime kapitale. Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Mamushës për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion pak më shumë se 1 milion euro për investime kapitale.

Tab.2.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Mamushës 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	826,789	911,150	911,150
Të hyrat vetanake në €	78,409	-	-
Investimet kapitale në €	243,338	263,338	263,338

Administrata komunale

Në komunën e Mamushës të dhënat për vitin 2009 tregojnë se numri i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë është 113. Krahasuar me vitin 2008, numri i shërbyesve civil është rritur për 28 persona. Duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.10/46 (3 dhjetor 2008), e cila thotë se për 620 banorë duhet të ketë një punëtorë administrative, del se komuna e Mamushës duhet të ketë 55 punëtorë administrativ. Momentalisht kjo komunë ka 31 punëtorë administrativ, qka do të thotë se ka të drejtë që të rekrutoj staf deri të arrihet shifra 55 punonjësish. Numri prej 55 punëtorëve administrativ është parë i nevojshëm në mënyrë që të mund të mbulohen të gjithë sektorët me staf të mjaftueshëm.

Tab.3. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Mamushës sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	113 ▲
2008	85 ▲
2007	82 ▲
2006	15 ■

Komuna e Mamushës dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sa i përket përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht numrit të mbledhje që duhet t'i mbaj kuvendi komunal gjatë një viti, e që duhet të jetë minimum 10 mbledhje në vit, KK i Mamushës gjatë vitit 2008 ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje. Kurse gjatë periudhës janar-qershor 2009, KK e Mamushës ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtëzakonshme, numër ky që është konform nenit 43.2 të ligjit të lartpërmendur. Ndërkaq, Komiteti për Politikë dhe Financa ka funksionalizuar normalisht, ku gjatë vitit 2008 është takuar gjithsej 8 herë, kurse në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje. Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimin strategjik të komunës.

Ndërsa sa i përket tubimeve publike që komuna ka mbajtur me qytetarët, Komuna e Mamushës gjatë vitit 2008 ka mbajtur 6 debate publike me qytetarë, kurse për gjashtëmujorin e parë të vitin 2009 janë mbajtur 2 tubime. Sa i përket kërkesave për qasje në dokumente zyrtare komuna e Mamushës nuk ka pasur ndonjë kërkesë deri më sot. Komuna gjithashtu nuk ka pranuar asnjë petition brenda dy viteve të fundit. Komuna e Mamushës nuk ka ueb faqe zyrtare.

Gjendja në arsim

Arsimi në Komunën e Mamushës zhvillohet në dy nivele, atë fillor dhe të mesëm. Komuna e Mamushës është ndër komunat e rralla në Kosovë që nuk kanë çerdhe fëmijësh e as nuk e kanë të iniciuar sistemin parashkollor të fëmijëve. Mamusha së voni ka ndërtuar shkollën fillore 'Haxhi Ymeri', një shkollë moderne e cila ka kushtuar afër 1.2 milion euro. Kjo komunë ka edhe shkollën e mesme. Numri i

nxënësve në shkollën fillore është 917 kurse numri i nxënësve në shkollën e mesme është 105. Ndërkaq, numri i mësuesve në këtë komunë është 55.

Gjendja në shëndetësi

Komuna e Mamushës ka vetëm Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe asnjë punkt tjetër shëndetësor. Në këtë qendër punojnë gjithsej 4 mjek, kurse numri i përgjithshëm i punonjësve shëndetësor është 8. Ndërtimi i QKMF-së ka qenë një ndër investimet kapitale të kësaj komune, natyrisht e ndihmuar nga donator të huaj, kryesisht nga Turqia. Sot QKMF punon në dy ndërrime dhe pritet që në të ardhmen t'i shtohet edhe ndërrimi i tretë.

Shoqëria civile

Komuna e Mamushës ka disa organizata jo qeveritare të cilat më shumë merren me aktivitete të tjera kulturore se sa me monitorim apo avokim në Kuvend Komunal. Disa nga OJQ-të e kësaj komune janë 'Shoqata Kulturo Artistike', 'Alperenler', 'Shoqata e Fermerëve të Komunës së Mamushës' e cila ka nën administrim rreth 180 fermerë, si dhe Shoqëria Kulturore Artistike 'Asik Ferki'.

Mediat lokale

Komuna e Mamushës nuk ka asnjë radio apo televizion lokal, dhe asnjë korrespondent për mediet e shkruara vendore. Në mungesë edhe të uebfaqes komunale, e vetmja mënyrë për marrjen e informacioneve në këtë komunë mbetet vizita e drejtpërdrejtë në organet komunale.

Rendi dhe ligji në Komunën e Mamushës

Në përgjithësi komuna e Mamushës konsiderohet si komunë e qetë ku respektohet rendi dhe ligji. Kjo mbase është edhe si pasojë e numrit jo edhe aq të madh të banorëve në këtë komunë. Edhe pse nuk ka stacion policor, në këtë komunë shpesh patrollojnë pjesëtar të Policisë së Kosovës dhe deri vonë kjo komunë ka qenë e frekuentuar mjaft edhe nga pjesëtarë të KFOR-it turk. Në mungesë të një stacioni autonom policor, nuk është e mundur nxjerrja e rasteve për shklejje rendit dhe ligjit në këtë komunë, ngase Mamusha nuk figuron si njësi e veçantë në kuadër të statistikave të Policisë së Kosovës.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përllogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore.

Tab.4. Tatimi në pronë në Komunën e Mamushës

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.12%	0.12%	0.15%	0.13%	0.10%
I	190€	190€	380€	280€	100€
II	160€	160€	320€	250€	80€

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Në komunën e Mamushës funksionojnë rreth 100 biznese private. Kjo komunë ka hartuar një draft të Rregullores komunale për taksa, gjoba dhe ngarkesa, të cilën e ka hedhur në dëgjim publike. Muk kemi mundur që të sigurojmë një kopje të kësaj rregulloreje me arsyetimin se ajo ende nuk është miratuar nga ana e Kuvendit Komunal dhe si e tillë ende nuk ka marr formën zyrtare.